



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
*Komisioni për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument Parlamentar

Tiranë më 11.07.2024

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2023**

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 05 qershor 2024, në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e nenit 204, pika 1, gërma “d”, e ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, dhe të Vendimit, nr.134/2018, si dhe neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim “Raportin për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Vitin 2023”.

Raporti vjetor pasqyron në vija të përgjithshme gjithë aktivitetin e institucionit, arritjet dhe problematikat e konstatuara dhe analizën e punës për vitin 2023.

Përmbledhja e Raportit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023, u prezantua nga Inspektori Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani.

II. Baza Ligjore

Në zbatim të nenit 148/b shkronja (d), të Kushtetutës, nenit 38, pika 2, shkronja (d), e nenit 204, pika 1, gërma “d”, e ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, dhe të Vendimit, nr.134/2018, si dhe neneve 18, dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur “Raportin për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Vitin 2023”.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, organizoi seancën dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve hartoi një projekt-rezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023 si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t’i realizojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, për vitin 2024.

III. Diskutimi në Komision

Gjatë diskutimeve në komision Z. Metani prezantoi raportin vjetor. Pas përfundimit të prezantimit të raportit vjetor, relatori e çështjes, i caktuar nga komisioni, Z. Plarent Ndreca parashtrroi mendimin mbi raportin, dhe vlerësoi veprimtarinë e ILD gjatë vitit 2023. Z. Ndreca i drejtoi disa pyetje Inspektorit lidhur me aspekte të veprimtarisë së tij.

Pas diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, u konstatuan disa arritje dhe problematika të këtij institucioni. Ndër problematikat e evidentuara ishin numri i lartë i ankesave të arkivuara, numri i ulët i procedimeve të magjistratëve, apo dhe nevoja për inspektime tematike mbi çështje të ndjeshme për publikun, si masat e sigurisë, afatet e hetimit, mungesat e prokurorëve në seanca gjyqësore, problematikat administrative të sistemit gjyqësor.

U evidentua nevoja për plotësimin e numrit të inspektorëve magjistratë, rezultat i numrit të ulët të aplikimeve apo mungesës së përfshirjes aktive të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. U konstatua nevoja për një bashkëpunim më të mirë ndërinstitutional, për një fokus në politikat edukuese dhe ndërgjegjësuese për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu u diskutua dhe përfundimi i procesit për vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve

Sa më sipër u sugjerua që të reflektohen në projektrezolutën që do miratohej nga Komisioni për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2024.

Në mbledhjen e datës 03 korrik 2024, Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, mori në shqyrtim projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024”.

IV. Përfundime

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni miratoi projektrezolutën me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqet për miratim seancës plenare, sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

Plarent NDRECA

KRYETARE

Klotilda BUSHKA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTREZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË PËR VITIN 2023**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.
- Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike.
- Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrin e Drejtësisë në kuadër të inspektimeve tematike dhe përmbushjes së detyrave të tjera funksionale.

Vlerëson veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2023, në këto drejtime:

- Trajtimit dhe përfundimit të plotë të shqyrtimit të 2104 ankesave të trashëguara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare (*backlog*), në mënyrë të paanshme dhe duke ndjekur parimin e proporcionalitetit, ku vetëm për vitin 2023 janë shqyrtuar më shumë se 50% e këtyre ankesave.
- Miratimit të 18 vendimeve për hetim disiplinor, në të cilat janë hetuar shkeljet e pretenduara për 25 magjistratë, nga të cilët 4 prokurorë dhe 21 gjyqtarë, kryesisht për shkelje të pretenduara në lidhje me vonesa të përsëritura dhe zvarritje të pajustificuara të akteve

procedurale si dhe veprime ose mosveprime që sjellin përfitime të padrejta ose dëme për palët në proces gjyqësor.

- Përfundimit të dy inspektimeve tematike, për të cilat janë lënë rekomandime të karakterit legjislativ, organizativ dhe mirëfunksionimit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen si të ndërgjegjësimit ashtu dhe të efikasitetit të veprimtarisë së organit të inspektuar.
- Fillimit të procesit për vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve dhe përfundimin e vlerësimit për njërin prej tyre, duke hapur rrugë ngritjes së komisioneve përkatëse për vlerësimin e inspektorëve, emërimin e inspektorëve jo-magjistrat dhe zgjedhjen e Zëvendës Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Rritjes së bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira të punës, ku mund të veçohet anëtarësimi me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë dhe angazhimi në projektin e nisur nga Komisioni Evropian “Bashkëpunimi për Mbrojtjen e Mjedisit nga Autoritetet Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë”.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për vitin 2024, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

1. Të adresojë nëpërmjet instrumenteve që i jep ligji, problematikat e ndjeshme për publikun, si institucion garantes i sistemit të drejtësisë, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të besimit të publikut jo vetëm për ILD-në por për të gjithë institucionet e sistemit të drejtësisë.
2. T’i kushtohet vëmendje e veçantë plotësimin të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat.
3. Të ndër marrë masa të rregullta për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të procesit të rivlerësimit, veçanërisht për inspektorët jo-magjistratë.
4. Të rritet numri i inspektimeve institucionale me objektiv të qartë dhe të përcaktuar, të fokusuar në aspektet specifike të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorisë mbi menaxhimin e çështjeve dhe administrimin gjyqësor dhe hetimor.
5. Të përfundojë vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve, në një kohë të arsyeshme dhe rezultatet e vlerësimit të përdoren për të zhvilluar programe trajnimi në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale.
6. Të angazhohet për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë, në drejtim të shkëmbimit informacionit, bashkëpunimit në hetime dhe inspektime tematike, si dhe koordinimin e veprimeve për të adresuar çështje të përbashkëta.
7. Të përmirësojë treguesit e transparencës dhe aksesueshmërinë e publikut, duke publikuar, informacione periodike, raporte dhe çdo të dhënë tjetër që reflekton veprimtarinë institucionale.
8. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.